


01-2459



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-299043/19 dt.09.12.2019, të pronarëve, Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani nga Podujeva, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019 dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës afariste, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban’ në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 21.01.2020, merr këtë:



V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË VENDIMIT 05 NR.350/02-179143/19 DT.26.09.2019, SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 05 NR.350/02-179143/19 DT.26.09.2019 DHE RI-CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

- I. **Miratohet** kërkesa 05 nr. 350/02-299043/19 dt.09.12.2019, në emër të Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani, nga Prishtina për plotësimin dhe ndryshimin e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019, përkatësisht ri-caktimin e kushteve ndërtimore. Përmes këtij Vendimi, kushtet ricaktohen për ndërtesë afariste me karakter të përhershëm, për dallim nga Vendimi 05 nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019.
- II. **Shfuqizohet** akti administrativ Vendimi 05 nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019, mbi caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1423-4 ZK Prishtinë, dhe kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimore merret në rishqyrtim.
- III. **Ri-caktohen kushtet ndërtimore** pronarëve Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani nga Podujeva, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-179143/19 dt.24.07.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për ndërtimin e ndërtesës afariste - depo, me etazhitet P+0, në kuadër të ‘Planit Zhvillimor Urban’, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1423-4 ZK Prishtinë.
- IV. **Lokacioni** i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të ‘Planit Zhvillimor Urban’, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Zonë ekonomike”.
- V. **Gjendja ekzistuese** e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:
 - Numri, sipërfaqja, pronari dhe lloji i shfrytëzimit të parcelës kadastrale, është:

- nr. 1423-4, me $S= 1000.0 \text{ m}^2$, me pronar Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani, "Tokë bujqësore - Arë e klasës 3";
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Parcela për të cilën lëshohen këto kushte të ndërtimit është e zbrazët dhe nuk ka ndërtesë të ndërtuar në të.
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është relativisht i rrafshët;
- Qasja e parcelës është direkt në rrugën publike, përkatësisht në rrugën 'Ramiz Çernica';
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është kryesisht afarizëm.

VI. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore (përveç në rastin e mos prezantimit të pëlqimeve të kërkuara në pikat më poshtë);
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas Planit Zhvillimor Urban, të jetë për, Afarizëm - i miratuar "depo".
- Etazhiteti i lejuar, sipas ndërtesave në diametër prej 50m' është është P+0;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës, sipas PZHU-së, është max.40%;
- Sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës (ISGJ), duhet të jetë së paku 40%, sipas Vendimit 01 Nr.031-185481 të dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 1H (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale - parcelës ndërtimore, është 0.75H, gjegjësisht 0.5H me kushtin e mos tejkalimit të distancës në mes dy ndërtesave, prej 1H.
- Vija ndërtimore nuk lejohet të tejkalohet me ballkone, konzolla, shkallë, rampa apo elementet të ngjashme;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Numri i parkingjeve që duhet të sigurohet është 4 VP / 100m², për ndërtesat e bizneseve, dhe 1 VP / 100m², për ndërtesat e depove;
- Në paraqitjen e situacionit të parcelës kadastrale, të paraqiten edhe organizimi i vendparkimeve të jashtme, rrugëve përreth parcelës, gjelbrimit të planifikuar, etj.;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/ dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

VII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimin Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m², me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zeytare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dymave dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiluarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro - energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujës-jellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;



- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kycje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

Dokumentacioni ndërtimor për **Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

IX. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 1423-4, Zona Kadastrale Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës - tokë bujqësore, me kulturë 'arë e klasës 3, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë, si dhe nenit 8 të Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik 01 nr.110-288305 dt.31.12.2014.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=1,000.00 \text{ m}^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

X. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

XI. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 - 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XII. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronarët, Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani nga Podujeva, me kërkesën 05 nr. 350/02-299043/19 dt.09.12.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, plotësimin dhe ndryshimin e Venimit 05 Nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019 mbi caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm, dhe ri-caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtesë afariste - depo, me karakter të përhershëm, me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr.1423-4, ZK Prishtinë, evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914059-01423-4, ZK Prishtinë;
- Informimin nga Plani Zhvillimor Urban - PZHU me referencë 2326 dt.10.07.2019, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Deklaratë-Pëlqim LRP.nr.rend.5955/2019 dt.18.07.2019 sipas të cilës, Xhevdet Krasniqi në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr.1423-39 ZK Prishtinë, dhe Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani në cilësinë e pronarëve të parcelës kadastrale nr.1423-4 ZK Prishtinë, japin pëlqimin e plotë dhe reciprok që ndërtimet në parcelat e tyre përkatëse të zhvillohen deri në distancë prej 1.0m' nga parcela fqinje;
- Deklaratë - Pëlqim LRP.Nr.rend.5954/2019 dt.18.07.2019, sipas të cilës, Bajram Kastrati në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr.1423-45 ZK Prishtinë, dhe Burim, Bahri, Bashkim dhe Mehmet Sylejmani në cilësinë e pronarëve të parcelës kadastrale nr.1423-4 ZK Prishtinë, japin pëlqimin e plotë dhe reciprok që ndërtimet në parcelat e tyre përkatëse të zhvillohen deri në distancë prej 1.0m' nga parcelat e fqijut në fjalë;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Junuzi, me licencë nr.31;
- Projektin konceptual për parcelën kadastrale në fjalë, të hartuar nga "Zh-Studio" sh.p.k., me seli në Prishtinë;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore;
- Fotokopjen e dokumenteve të identifikimit-letërnjoftimit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, si dhe dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Planit Zhvillimor Urban, si dhe bazuar në rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, u konstatua se bazuar në



nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, kjo Drejtori veç ka vendosur njoftimin publik me datë 15.08.2019, për ndërtesë afariste. Si rrjedhojë, meqë sipërfaqja, etazhiteti dhe për më tepër destinimi i ndërtesës nuk kanë ndryshuar sipas kësaj kërkesë, kjo Drejtori konsideron se ka përfunduar procedurën e njoftimit publik, për të cilin nuk ka arritur ndonjë ankesë, sygjerim apo vërejtje, brenda afatit të përcaktuar.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë, u konstatua se kërkesa paraprake 05 Nr.350/02-179143/19 dt.24.07.2019, bashkarisht me dokumentacionin e prezantuar në të, është shqyrtuar si kërkesë për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm, andaj për të njejtën është nxjerr Vendimi 05 Nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019. Ndërkohë, pas pranimit të të njëjtit, aplikuesi ka vënë re se Vendimi nuk është nxjerr për ndërtesë me karakter të përhershëm, siq edhe ka qenë kërkesa e tij. Si rrjedhojë, me kërkesën 05 Nr.350/02-299043/19 dt.09.12.2019, aplikuesi ka kërkuar plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 05 Nr.350/02-179143/19 dt.26.09.2019, përkatësisht ka kërkuar që ndërtesa që është subjekti i këtij Vendimi, të trajtohet si ndërtesë me karakter të përhershëm.

Si rrjedhojë, kjo Drejtori ka shqyrtuar kërkesat në fjalë dhe dokumentacionin e bashkangjitur në to, ka konsultuar legjislacionin në fuqi si dhe ka konsultuar Planin Zhvillimor Urban, ku shtrihet parcela në fjalë, dhe ka konstatuar se ndërtesa në kuadër të parcelës në fjalë, mund të trajtohet edhe si ndërtesë me karakter të përhershëm, duke qenë se është në përputhje me kriteret e Planit Zhvillimor Urban për zonën në fjalë.

Njëherit, është konsultuar edhe faza e komunikacionit, dhe sipas mendimit të dt.25.09.2019, "kyçja për automjete në rrugën ekzistuese "Ramiz Cërnica", respektivisht në rrugën e planifikuar sipas PZHU-së, sipas prezantimit në situacion për ndërtesën afariste - depo me etazhitet P+0, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes edhe në kohën kur realizohet ajo".

Bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", kjo Drejtori, ka konstatuar se aplikuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Shtojcë: Plani i situacionit për parcelën dhe ndërtesën në fjalë.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror - MMPH-ja.

Ky Vendim u përpilua në pesë (5) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit, në dosje të kësaj lënde, në dosje të lëndës 05Nr.350/02-179143/19, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike e këtij Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshmë dhe Drejtorisë së Kadastrit.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS


05 Nr. 350/02-299043/19 dt. 20.01.2020

Punoi,
Krenare Shkodra

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshaj



Faqe 6 prej 6



91

Rrugë e planifikuar

Rrugë ekzistuese

OBJEKTI-DEPO E DYERVE DHE DRITAREVE P+0		OBJEKTI	
Zona industriale PRIFTINE, Zona ekonomike, Rg industriale 0423-4		Zona industriale PRIFTINE, Zona ekonomike, Rg industriale 0423-4	
INVESTITOR	Mehmet Sylejmani, Bahri Sylejmani, Burim Sylejmani, Bashkim Sylejmani	PROJEKTOR	ZH-STUDIO
arkitekt	Msc.Arch. Blerta Spahija DATA KORRIK 2019	PERPIESA	1:200
PROJEKTI IDEOR		PERMBAJTA	SITUACIONI I NGUSHTE



